



FONDI SHQIPTAR  
I ZHVILLIMIT

---

# SHËRBIME KONSULENCE PËR MBËSHTETJE TEKNIKE PËR HARTIMIN E DOKUMENTAVE TEKNIKE PËR:

Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me  
popullsi të dendur, etj Rajonet 1&2

## Raporti teknik




Nëntor, 2024

KONSULENTI:



<b>Porositësi:</b>	<b>Fondi Shqiptar i Zhvillimit</b>
<b>Konsulenti:</b>	<b>Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.</b>
<b>Objekti:</b>	<b>Shërbime konsulence për mbështetje teknike për hartimin e dokumentave teknike për: Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur, etj Rajonet 1&amp;2</b>
<b>Titulli i Dokumentit:</b>	<b>Raporti teknik</b>
<b>Faza e Projektit:</b>	<b>Projekt Ideja Paraprake</b>
<b>Kodi i dokumentit:</b>	<b>ICE-361-P01-V01 02 06</b>

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për miratim		05.11.2024

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Vasil Leka  Taulant Karriqi 	Olset Haxhiu			
Data:	05.11.2024	05.11.2024	05.11.2024		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2024

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

## PËRMBAJTJA

Përmbajtja .....	i
Lista e Tabelave .....	ii
Lista e Figurave .....	iii
1 Hyrje .....	1
2 Rigjenerimi urban në zonat periferike, informale dhe në fshatra me popullsi të dendur .....	2

## LISTA E TABELAVE

[No table of figures entries found.](#)

## **LISTA E FIGURAVE**

**No table of figures entries found.**

## 1 HYRJE

Qëllimi kryesor projektit është rritja e cilësisë së jetës së komuniteteve që popullojnë në zonat urbane, lidhja e zonave turistike që kanë potencial për zhvillimin ekonomik dhe social. Ndërhyrjet do përmirësojnë qarkullimin e automjeteve, njerëzve dhe do të rrisë sigurinë e lëvizjes.

Projekti “ Rigjenerimi urban në zonat periferike, informale dhe në fshatra me popullsi të dendur “ është parashikuar të financohet në kuadër të Programit Operacional 2022-2024 të FSHZH-së, miratuar me Vendimin Nr. 225 Datë 23.03.2022 të Këshillit Drejtues të FSHZH.

Proceset e rehabilitimit urban janë ndërhyrje me ndikim të lartë në territor dhe mbi dimensionet e sistemit të jetës në tërësi. Këto procese aplikohen në zonat urbane të cilat karakterizohen nga humbja e funksionalitetit ekzistues, në zona ku ka mungesë të infrastrukturës publike dhe mangësi në përmbushjen e standardeve urbane. Për këtë arsye, planifikohet realizimi i ndërhyrjeve që rikonceptojnë zonat urbane për të rikthyer standardet e projektimit të cilat bazohen në mirëqenien fizike dhe përtej.

Nëpërmjet këtij Projekti synohet rritja e cilësisë së jetës së komuniteteve që popullojnë zonat urbane. Rehabilitimi i blloqeve urbane krijon një sistem të përmirësuar në të cilin zhvillohet jeta e banorëve të zonave. Ndërhyrjet rigjeneruese në blloqet e banimit janë ambientet më të prekshme nga banorët e zonave për shkak se përbëjnë habitatin në të cilin zhvillohet jeta e përditshme. Ky projekt parashikon rikualifikim të zonave dhe blloqeve të banimit, duke i rikonceptuar dhe kthyer, nga hapësira të degraduara, në hapësira të reja për banorët, me standarde të larta të ndërtimit etj.

Ne këtë projekt përshkruhet rehabilitimi i blloqeve urbane në zonat periferike, informale dhe në fshatra me popullsi të dendur duke i rikonceptuar dhe kthyer, nga hapësira të degraduara, në hapësira të reja për banorët, me standarde të larta të ndërtimit etj. Këto procese aplikohen në zonat urbane të cilat karakterizohen nga humbja e funksionalitetit ekzistues, në ato zona ku ka mungesë të infrastrukturës publike dhe mangësi në përmbushjen e standardeve urbane.

Përfituesit do të jenë të gjitha Bashkitë në të cilat do të aplikohet ndërhyrja.

Objekti i punës do të jetë përcaktimi i tipologjive të ndërhyrjeve, koston se përafërt të ndërtimit, raport dhe specifikime teknike për zëra tip, duke paraqitur disa modele tip (seksione rruge, seksione asfaltike, tipologji fasade sipas kushteve klimaterike etj.) për çdo ndërhyrje të propozuar.

## 2 RIGJENERIMI URBAN NË ZONAT PERIFERIKE, INFORMALE DHE NË FSHATRA ME POPULLSI TË DENDUR

### **Përshkrimi teknik i projektit dhe mënyra e ndërhyrjes:**

Implementimi i këtyre projekteve ka si qëllim të përmirësojë qarkullimin e automjeteve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve.

### **Përshkrimi i Rubrikave për zërat e punimeve sipas preventivit bashkëngjitur:**

#### **Rubrika A: PUNIME PRISHJE DHE EVADIMI TE MBETURINAVE**

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet e mureve prej blloqe betoni, strukturave prej betoni, mureve të tullës dhe transporti.

#### **Rubrika B: PUNIME PER NDERTIMIN E RRUGES DHE TROTUARET**

Në këtë rubrikë përfshihen gërmimet, mbushjet shtresat rrugore dhe kunetat, bordurat dhe trotuaret.

#### **Rubrika C: PUNIME NDERTIMI E VEPRA ARTI (MUREVE MBAJTES, ETJ)**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet për ndërtimin e veprave të artit, si tombino, muret mbajtës dhe pritës, muret me gabiona etj.

#### **Rubrika D: PUNIME PER KANALIZIMET E UJRAVE TE BARDHA**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet për kanalizimin e ujerave të bardha si gërmimi, tubat dhe pusetat.

#### **Rubrika E: PUNIME PER UJESJELLESIN**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet për ujësjellësin si gërmimi, tubat dhe pusetat dhe hidrantët.

#### **Rubrika F: PUNIME ELEKTRIKE**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet për spostimin e linjave elektrike dhe ndriçimin rrugor.

#### **Rubrika G: PUNIME NE RESTAURIM**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet e restaurimit ne fshatrat turistike si ndërtim qemeri me gurë të gdhendur, restaurim mur guri me llac gëlqere, restaurim i çarjeve të murit, cati me tjegulla, fugatim muri etj.

#### **Rubrika H: PUNIME PER GJELBERIMIN DHE MOBILIMIN URBAN**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet për gjelbërimin dhe mobilimin urban si mbjellje bari. Mbjellje pemësh, vendosje kosha mbeturinash dhe stola.

#### **Rubrika I: PUNIME PER RIPARIM DHE LYERJE FASADASH**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet e fasadave ku përshihen riparimi i suvasë, i kullimit, dhe lyerja e fasadave.

#### **Rubrika J: PUNIME PER SINJALISTIKEN**

Në këtë rubrikë përfshihen punimet për sinjalistikën rrugore ku përfshihet sinjalistika horizontale dhe vertikale.

### **Siguria dhe shëndeti në pune**

Gjatë zbatimit të punimeve duhet të respektohen me rigorozitet të gjitha kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kushtet teknike si dhe praktikat më të mira.

I gjithë personeli duhet të jetë i trajnuar në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë përpara se të hyjë në kantier. Drejtuesit e makinerive të ndërtimit duhet të jenë të pajisur me certifikatat dhe lejet përkatëse të drejtimit. Duhet bërë rrethimi dhe mbrojtja e kantierit në zonat ku do të kryhen punime.

### **Vendndodhja e objektit**

- Bazuar në kërkesat e Njësive të Qeverisjes Vendore (Nj.V.V) stafi i FSHZH ka përgatitur një listë paraprake të zonave në gjithë territorin e Shqipërisë, në të cilat parashikohet të ndërhyhet për rritjen e qëndrueshmërisë së tyre.

- Bazuar në fondin e parashikuar për këtë projekt, do të mundësohet trajtimi i disa prej këtyre zonave, të cilat janë të rëndësishme dhe janë prioritare.

### **Impakti i investimit**

- Sigurimi i lëvizjes së automjeteve në rrugë;
- Rritja e sigurisë rrugore;
- Përmirësimi i aksesit në rrugë;
- Përmirësimi i zonës së banimit;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve.



